



VENDIM MBI PRANUESHMËRI

Data e miratimit: 5 tetor 2012

Nr. i lëndës 2011-07

W

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 5 tetor 2012, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Znj. Verginia MICHEVA-RUSEVA, anëtare
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesë është regjistruar më 11 prill 2011. Më 25 nëntor 2011 Paneli ka kërkuar informata shtesë nga shefi i misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë. Kjo informatë ishte pranuar më 19 janar 2012.
2. Më 20 mars 2012 Paneli ka vendosur që ta njoftoj ShM-në lidhur me ankesën, duke e ftuar atë që të paraqes vërejtjet e tij me shkrim rreth kësaj ankese. Vërejtjet nga ShM ishin pranuar më 4 maj 2012, ku

pastaj ato ishin përkthyer dhe dërguar tek parashtruesi i ankesës në mënyrë që ai të ofroj vërejtjet e tij shtesë.

3. Më 16 qershor 2012 parashtruesi i ankesës ka takuar Sekretariatën e Panelit dhe ka paraqitur gojarisht vërejtjet e tij.
4. Nuk ishte kërkuar ndonjë vërejtje tjetër.
5. Në mënyrë që të ruhet siguria, privacia dhe identiteti i parashtruesit të ankesës, Paneli ka vendosur, *proprio motu (me vetiniciativë)*, që të fshijë emrin e parashtruesit të ankesës nga ky vendim. Ai do të përmendet si W.

II. FAKTET

6. Faktet e lëndës, ashtu siç janë parashtruar nga parashtruesi i ankesës, dhe siç paraqiten nga dokumentet në dispozicion të Panelit, mund të përmbliidhen si në vijim.

Të dhënat paraprake

7. Sipas parashtruesit të ankesës, ai dhe disa fshatarë të tjerë ishin dëshmitarë të vrasjes së 109 civilëve nga forcat serbe gjatë tri incidenteve të ndara në fshatin Lubeniq, në zonën e Pejës, midis majit 1998 dhe prillit 1999.

Hetimi nga EULEX-i

8. Parashtruesi i ankesës dhe një numër i personave të tjerë janë takuar me udhëheqësin e ekipit të njësisë për hetimin e krimeve të luftës së EULEX-it (më tutje: hetuesi i EULEX-it) për herë të parë në muajin maj të vitit 2010 në lidhje me hetimin e këtyre incidenteve. Pas kësaj kanë pasuar disa takime të tjera, disa takime me ekipin e njësisë për hetimin e krimeve të luftës së EULEX-it dhe disa takime të tjera me zyrën e prokurorit special të Kosovës (PZPSK).
9. Në këtë kontest, parashtruesi i ankesës dhe persona të tjerë kanë ofruar disa deklarata tek hetuesit e EULEX-it. Parashtruesi i ankesës ka ofruar deklaratën e tij të parë më 20 korrik 2007 dhe një deklaratë tjetër më të zgjeruar më 27 korrik 2010.
10. Gjatë një takimi vijues me hetuesit e EULEX-it, personave të cilët kishin dhënë deklaratat në lidhje me ato ngjarje supozohet se iu ishte thënë prej hetuesve të EULEX-it se hetimi nga ana e EULEX-it do të përfundoj së shpejti dhe se ndjekja penale e rastit mund të merrej përsipër nga ana e autoriteteve serbe. Dëshmitarët kundërshtuan një veprim të tillë dhe kërkuar që hetimi të kryhej nga EULEX-i. Nuk ka ndonjë tregues se ka pasur ndonjë përgjigje, edhe nëse ka ndonjë, nga hetuesi i EULEX-it ndaj këtyre kundërshtimeve.

11. Gjatë gjithë hetimit me hetuesit dhe prokurorët e EULEX-it, parashtruesi i ankesës dhe dëshmitarët e tjerë kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me EULEX-in. Sidoqoftë, ata kundërshtuan që të lejohet dërgimi i deklaratave të tyre tek autoritetet serbe, për shkak të shqetësimit që lidhet me sigurinë e tyre dhe të familjeve të tyre.
12. Më 30 mars 2011, pesë persona të cilët i kishin dhënë deklaratat në EULEX kërkuan t'i tërheqin deklaratave të tyre. Për atë qëllim në kërkesën e tyre ata shprehën mosbesimin e tyre në EULEX, pasi që EULEX-i po bashkëpunonte me autoritetet serbe. Parashtruesi i ankesës nuk ishte në listën e emrave të atyre pesë personave.
13. Në tetor 2011, disa persona të cilët kishin kërkuar tërheqjen e deklaratave të tyre ishin kontaktuar nga EULEX-i. Ata e drejtuan EULEX-in tek parashtruesi i ankesës. Një takim ishte dashur të mbahej në tetor 2011 në mes të EULEX-it dhe parashtruesit të ankesës, mirëpo ai takim nuk ishte mbajtur. Nuk janë sqaruar arsyet për këtë.
14. Parashtruesi i ankesës ka kontaktuar me Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës rreth dërgimit nga EULEX-i i deklaratave të tij tek autoritetet serbe. Në kërkesën e tij drejtuar Avokatit të Popullit, parashtruesi i ankesës ka treguar se EULEX-i fillimisht kishte marrë përsipër se kjo lëndë do të procedohej në Kosovë para se të njoftohej *post factum* (pasi që ishte kryer akti) se deklaratat e tij i ishin dërguar autoriteteve serbe.

Informata shtesë të marra nga EULEX-i

15. Paneli ka pranuar informata kundërtënëse nga EULEX-i lidhur me natyrën e hetimit të këtij rast. Në përgjigjen fillestare të pranuar më 17 janar 2012, Paneli ishte njoftuar se hetimi në mes të EULEX-it dhe autoriteteve serbe ishte hetim "i përbashkët". Më vonë ajo informatë ishte tërhequr dhe në vend të saj Paneli ishte njoftuar se ka pasur dy hetime (një hetim nga EULEX-i dhe një hetim nga autoritetet serbe) dhe bashkëpunim *joformal* në mes të EULEX-it dhe autoriteteve serbe në lidhje me rastin.

III. ANKESAT

16. Parashtruesi i ankesës pretendon që EULEX-i ka shkelur të drejtat e tij të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa) pasi që ka dërguar deklaratat e tij tek autoritetet serbe pa vullnetin e tij. Ai pretendon se e ndjen veten të kërcënuar pasi që emri i tij është zbuluar tek autoritetet serbe, të cilëve ai nuk iu beson.
17. Përderisa parashtruesi i ankesës nuk i ka paraqitur në mënyrë të veçantë të drejtat e Konventës të cilat ai pretendon se iu ishin shkelur

nga EULEX-i, është e qartë nga përmbajtja e aplikacionit të tij se ankesa e tij ka të bëjë me të drejtat e mbrojtura të paraqitura si në vijim:

- E drejta për jetën, e garantuar, *ndër të tjerash*, me nenin 2 të Konventës;
- Të drejtat për mos t'iu nënshtruar torturës, trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës të garantuara, *në mes të tjerash*, me nenin 3 të kësaj Konvente; dhe
- E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare e garantuar, *ndër të tjerash*, me nenin 8 të kësaj Konvente.

IV. LIGJI

Shënime të përgjithshme

18. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos se a do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin e pranueshmërisë të përcaktuar në rregulloren 29 të rregullores së punës.
19. Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut që i ngarkohen EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave siç përcaktohet në rregullën 25, paragrafin 1 të rregullores së vet të punës.
20. Në këtë ankesë, parashtruesi i ankesës ishte intervistuar si dëshmitar i mundshëm nga EULEX-i në lidhje me një rast që përfshinë vrasje të dyshuara masive të civilëve në Kosovë. Parashtruesi i ankesës është banor i Kosovës, ndërsa të dyshuarit besohet se jetojnë në Serbi.
21. Paneli tashmë ka konstatuar se veprimet e ndërmarra nga prokurori i EULEX-it apo policisë gjatë shqyrtimit të një rasti janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë, prandaj hyjnë në kuadër të mandatit të Panelit (shih për shembull *Latif Fanaj kundër EULEX-it*, nr. 2010-06, vendimi i datës 14 shtator 2011; *S.M. kundër EULEX-it*, nr. 2011-11, vendimi i datës 23 nëntor 2011; *Hoxha kundër EULEX-it*, nr. 2011-18, vendimi i datës 23 nëntor 2011; *Thaqi kundër EULEX-it*, nr. 2010-02, vendimi i datës 14 shtator 2011).

Shkeljet e dyshuara të neneve 2, 3 dhe 8 të Konventës

22. Parashtruesi i ankesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të përcaktuara në Konventë, pasi informatat që ai i kishte ofruar EULEX-it ishin dërguar autoriteteve serbe kundër vullnetit dhe kundërshtimit të tij. Ai nuk pretendon se ka ndonjë kërcënim të veçantë ndaj tij apo familjes së tij, mirëpo pohon se zbulimi i atij informacioni tek autoritetet serbe mund të krijoj rreziqe serioze për të dhe familjen e tij. Prandaj kjo ankesë do të shqyrtohet sipas neneve 2, 3 dhe 8 të Konventës.

23. Në dispozitat përkatëse të Konventës thuhet si në vijim:

Neni 2 E drejta për jetën

E drejta e çdo njeriu për jetë mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

Neni 3 Ndalimi i torturës

Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

Neni 8 E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdokush ka të drejtë në respektimin të jetës së tij private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse siç parashikohet me ligj dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, apo mirëqenies ekonomike të shtetit, për pengimin e trazirave apo krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

a. Dokumentet e paraqitura nga palët

24. Në dokumentet e paraqitura nga ai, ShM ka pohuar se zbulimi i deklaratave të parashtruesit të ankesës tek zyra e prokurorit të Serbisë nuk është bërë kundër vullnetit të parashtruesit të ankesës, pasi iu tha se ai ishte njoftuar rreth saj dhe iu tha se nuk është ankuar rreth saj. Sipas ShM, parashtruesi i ankesës gjithashtu ishte njoftuar rreth mundësisë se gjykimi mund të mbahej në Serbi, përderisa disa prej të dyshuarve tashmë ishin të arrestuar në Serbi. Asnjë e dhënë me shkrim e dokumenteve përkatëse nuk ishte paraqitur.
25. Për më tepër, ShM pohoi se ZPSK po bashkëpunonte rregullisht me homologët e tyre serbë në lidhje me hetimet që po zhvilloheshin, në veçanti në lidhje me shkëmbimet e informatave.
26. Në përgjigje ndaj vërejtjeve të ShM, parashtruesi i ankesës ka ritheksuar ankesat e tij të mëparshme. Ai pohoi se kur ia kishte ofruar informatat hetuesve të EULEX-it, ai nuk ishte i njoftuar se ajo informatë mund t'i ofrohej autoriteteve serbe dhe se ai vazhdoi të këmbëngul se ajo informatë nuk ishte dashur t'i ofrohej atij autoriteti. Ai shprehu frikën rreth sigurisë së tij dhe të familjes së tij.
27. Parashtruesi i ankesës pohoi se rasti duhet të hetohet nga EULEX-i dhe pastaj nga autoritetet e Kosovës. Ai ritheksoj faktin se ai dhe dëshmitarët e tjerë ende ishin të gatshëm të bashkëpunojnë me hetuesit e EULEX-it. Sidoqoftë, ata kishin kundërshtuar kryerjen e hetimeve nga ana e autoriteteve serbe, pasi ai nuk iu besonte atyre.
28. Nuk ka asnjë shënim me shkrim që para se të zbuloheshin deklaratat e tij tek autoritetet serbe EULEX-i e kishte njoftuar parashtruesin e ankesës se do të bëhej një gjë e tillë. Shënimet në dispozicion të

Panelit tregojnë se parashtruesi i ankesës ishte i njoftuar rreth atij fakti vetëm pasi që deklaratat e tij iu kishin dërguar autoriteteve serbe.

b. Vlerësimi i Panelit

29. Paneli konsideron se, sipas dokumenteve të paraqitura nga palët, kjo ankesë ngrit një çështje serioze sa i përket faktit dhe ligjit sipas neneve 3 dhe 8 të Konventës, përcaktimi i të cilave kërkon shqyrtimin e meritave. Prandaj, Paneli konstaton se kjo ankesë nuk është e pabazuar. Nuk është konstatuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur këtë ankesë të papranueshme.
30. Dëshmia e paraqitur në Panel është e pamjaftueshme për të nxjerrë përfundimin se jeta e parashtruesit të ankesës apo e të afërmeve të tij ishte vënë në rrezik si pasojë e veprimit që i ngarkohet EULEX-it. Kjo pjesë e ankesës, e cila ka të bëjë me një shkelje të dyshuar të nenit 2 të Konventës nga ana e EULEX-it është qartazi e pabazuar dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri

SHPALL TË PRANUESHME ankesat, pa paragjykuar meritat, sa i përket shkeljeve të dyshuara të neneve 3 dhe 8 të Konventës;

SHPALL TË PAPRANUESHME PJESËN TJETËR TË ANKESËS;

I PROPOZON SHEFIT TË MISSIONIT TË MERREN MASAT E PËRKOHSHME TË PARAQITURA NË VIJIM NË PAJTIM ME RREGULLËN 22 TË RREGULLORES SË PUNËS SË PANELIT:

1. Prokurorët e EULEX-it të ngarkuar me këtë lëndë duhet të ftohen që të kërkojnë nga homologët e tyre serb që t'u kthejnë kopjet e secilit dokument që iu është ofruar atyre, e që mbajnë emrin apo përmendin parashtruesin e ankesës. Kjo përfshinë që të dy deklaratat që parashtruesi i ankesës i ka dhënë EULEX-it.
2. Prokurorët e EULEX-it të ngarkuar me këtë lëndë duhet të ftohen që të kërkojnë nga homologët e tyre serb:
 - i. Të asgjësojnë secilën kopje të bërë nga dokumentet e lartpërmendur dhe ta rregullojnë emrin dhe secilën informatë në dokumentet e tjera që mund të identifikoj parashtruesin e ankesës; dhe
 - ii. Të njoftoj prokurorët e EULEX-it se kjo gjë është kryer; dhe
 - iii. Mos t'i zbulohet asnjë informatë që parashtruesi i ankesës i kishte ofruar EULEX-it ndonjë të dyshuari apo të pandehuri.

FTON shefin e misionit të parashtrorj çfarëdo dokumenti shtesë lidhur me meritat e lëndës nëse dëshiron.

Për Panelit,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese